



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 69 datë 21.12.2022

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PËR ANTENAT E TELEFONISË CELULARE, PRONË E BASHKISË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronesi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor/kullor për antenat e telefonisë celulare të subjektit “One telecommunications sh.a”, në pronesi të bashkisë Shkodër, të sipërfaqeve pyjore të detajuar me të dhënat si më poshtë :
 - Sipërfaqe pyjore 205m² (0.0205ha), në ekonominë pyjore Rosek-Rrjoll ngastra 3, N.J.A Postribë.
 - Sipërfaqe pyjore 205m² (0.0205ha), në ekonominë pyjore Lugina e Kirit ngastra 203a, N.J.A Pult .

- Sipërfaqes pyjore 205m² (0.0205ha), në ekonominë pyjore Pruemos-Sheldi ngastra 104, NJA Guri i Zi.

Nr	Ekonomia Pyjore	Përdorimi Territorit	Tarifa sipas kohezgjatjes lek/ha/vit	Sipërfaqja ha	Tarifa e rregulluar sipas kohezgjatjes lek/km/vit	Gjatesia km	TOTAL lek/vit
			1-5 vjet		1-5 vjet		
1.	EP Rosek -Rrjoll, NJA Postribe	Kullote	8 500 000	0.0205	70 000	0.35	198 750
2	EP Lugina e Kirit NJA Pult	Pyll-trungishte	11 250 000	0.0205	70 000	0.026	232 445
3	EP Pruemos Sheldi NJA Gur i Zi	Kullote	8 500 000	0.0205	70 000	0.11	181 950

2. Afati i dhënies në përdorim 5(pesë) vite.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR



Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 23.12.2022